



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

PROJEKTLIGJ

Nr. ____/2017

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9948, DATË 7.7.2008, “PËR
SHQYRTIMIN E VLEFSHMËRISË LIGJORE TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË
PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 17, fjalia e dytë, e shkronjës “e” të pikës 1/1”, ndryshohet si më poshtë:

“e. Afati i plotësimit të AMTP-ve përfundon në datën 31 korrik 2018.”

Neni 2

Neni 18, ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

Verifikimi i titujve të pronësisë, sipas dispozitave të këtij ligji, përfundon më 31 korrik 2018.”

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI